L I G J
Nr.7785, datë 27.1.1994

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7710, DATË 18.5.1993 "PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993, në nenin 7, pika 2, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Masa e ndihmës ekonomike mujore për familjen është jo më e vogël se 50 për qind dhe jo më e madhe se 100 për qind e të ardhurave të familjes, kur një ose dy persona përfitojnë pagesë papunësie".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet prej 1 janarit 1994.

Shpallur me dekretin nr.765, datë 9.2.1994, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë , Sali Berisha.